

VENDIM
Nr. 31, datë 23.1.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIM I QENDRËS SË QYTETIT ÇOROVODË”, FAZA E DYTË, BASHKIA
SKRAPAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i qendrës së qytetit Çorovodë”, faza e dytë, Bashkia Skrapar.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “ndërtesë”, me sipërfaqe 149.1 (njëqind e dyzet e nëntë pikë një) m², me vlerë të përgjithshme prej 2 467 950 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 467 950 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Skrapar, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Skrapar.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Skrapar.
 8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Skrapar të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Skrapar, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Skrapar.
 10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar dhe Bashkia Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit

**“Rivitalizimi i rrugës ‘Dëshmorët’ Çorovodë”, faza e dytë
, Bashka Skrapar**

Nr.	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë/	Sip. e ndërt./m ²	Vlera e përgj. /lekë	Lloji i dokumentit
1	Gramoz Hysen Qafoku	1420	3 / 46	ndërtesë	114	1 759 320	Vërtetim pronësie
2	Neshat Bajram Biraku	1420	4,/ 10	ndërtesë	35.1	708 630	Vërtetim pronësie
	TOTALI				149.1	2 467 950	